

INSPEKTORATI SHITETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL						
Regjistri i Kërkesave/Ankesave dhe Përgjigjeve ISHTI NËNTOR 2025						
Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e Përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	04.11.2025	Në kuadër të bashkëpunimit mes strukturave të institucioneve lidhur me kontrollin e produkteve energjetike, po ushtrohet kontroll pranë një pike karburanti, lutemi që strukturave tona ti bashkohen edhe përfaqësues nga ISHTI për të kryer verifikimet e përkatëse.	04.11.2025	Në vijim të kërkesës me email me datë 04.11.2025, Protokolluar në ISHTI me Nr. 10910 Prot datë 04.11.2025 dhe në zbatim të ligjit Nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Inspektorët e ISHTI të pajisur me Autorizimin me Nr. 10910/1 Prot datë 04.11.2025 kanë inspektuar subjektin, ku nga verifikimet e kryera është mbajtur Procesverbal me Nr. 10910/1 datë 05.11.2025. Në vijim, Inspektorët e ISHTI të pajisur me Autorizim, kanë inspektuar subjektin, nga verifikimet e kryera është mbajtur Procesverbal me Nr. 10910/4 datë 07.11.2025	E plotë	0
2	05.11.2025	Kërkesë/ankesë për ndërhyrje urgjente dhe verifikim të situatës së sigurisë dhe certifikatave të sigurisë nga banorët të një pallati në Tiranë Në hyrje të pallatit, ngjitur me shkallët dhe hyrjen kryesore të banesës, është vendosur një bombol gazi e përdorur nga restoranti i hotelit ngjitur, si dhe bombola e naftës me një distancë prej rreth gjys metri nga njëra-tjetra dhe distancë më pak se 1 metër nga pallati. Sipas vëzhgimit tonë, bombola e gazit ka një kapacitet prej rreth 800–1000 litrash, ndërsa ajo e naftës mbi 1000L. Nafta përdoret për funksionimin e gjeneratorit të hotelit në rast ndërprerjesh të energjisë elektrike, ndërsa gazi përdoret për gatimin në kuzhinën e hotelit. Ky pozicionim përbën rrezik të lartë për sigurinë e banorëve të pallatit dhe të kalimtarëve, pasi vëndndodhja e këtyre bombolave është në një zonë të banuar, me qarkullim të lartë dhe pa masat e nevojshme mbrojtëse. Jemi të shqetësuar për afërsinë e bombolave me pallatin dhe për mungesën e kushteve mbrojtëse për ruajtjen e lëndëve djegëse në këtë vend. Për këtë arsye, kërkojmë që Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial të dërgojë një grup inspektimi në terren për të verifikuar situatën dhe për të marrë masat e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim garantimin e sigurisë së banorëve dhe pronës private. Qëllimi ynë është të sigurohemi se pallati dhe banorët e tij janë në kushte të plota sigurie, sipas legjislacionit në fuqi	07.11.2025	Në përgjigje të ankesës tuaj dërguar me email pranë Ishtit, me Nr.10929 Prot, datë 05.11.2025 ju bëjmë me dije se u ushtrua kontroll nga inspektorët e ISHTI-it në zbatim të Autorizimit Nr. 10937 Prot, datë 05.11.2025 në subjekt. Subjekti, dispononte një rezervuar GLN-je i cili shërbente për përdorim në kuzhinën e restorantit. Në komunikim me personat përgjegjës u evidentua se rezervuari GLN ndodhej gjysëm nëntokë, jashtë përdorimit dhe jo plotësisht i montuar pasi subjekti ishte duke kryer shërbimet e nevojshme dhe plotësimin e plotë të kushteve Tekniko-Ligjore.Pranë rezervuarit GLN gjendej një depozitë e cila ishte përdorur për të mbajtur naftë e çmontuar dhe pa naftë. Pranë tij ndodhej edhe një gjenerator i cili përdorej në shërbim të hotelit në rast emergjence, nëse do të kishte shpëputje të energjisë elektrike. Ndodhur në këto kushte, subjektit iu la detyrë të heqë depozitën që përdorej për të mbajtur naftë si dhe gjeneratorin ndodhur pranë saj. Përsa më sipër subjektit u dhanë rekomandime që në rast se do të përdorin pajisje nën presion para vendosjes në punë të saj duhet të plotësojë gjithë dokumentacionin përkatës tekniko-ligjor në zbatim të sipas ligjit Nr.32 datë 24.03.2016 “ Për Garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion” si dhe të informojë ISHTI-n.	E plotë	0

